

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Balkan Finance Investment Group, BALFIN Group, është një nga grupet investuese më të rëndësishme dhe më të suksesshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjeografikisht, Grupi BALFIN është i pranishëm në Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni Veriore, Mali i Zi dhe Holandë, me afërsisht 6'000 punonjës në total. Aktivitetet e Grupit BALFIN përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të patundshme, shitjet me pakicë, industrinë minerare, sistemin bankar, turizmin, energjinë, logjistikën, etj. Grupi BALFIN po rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe kontribuon në përmirësimin e jetesës së komuniteteve përmes zhvillimit ekonomik, prezantimit të ideve të reja, punësimit dhe investimeve sociale.

TIRANA BANK, një nga bankat kryesore në Shqipëri dhe anëtare e **Grupi BALFIN**, mirëpret kandidatë të kualifikuar për t'iu bashkuar skuadrës së **Departamentit të Kontrollit të Brendshëm** në pozicionin:

Përkufizimi i pozicionit:

Auditori i Brendshëm do të jetë përgjegjës për të kryer të gjitha dhe çdo lloj auditimi për të gjitha njësitë, aktivitetet e degës dhe palët e treta që ofrojnë shërbime thelbësore (kritike) për Tirana Bank, në mënyrë që të formojë një mendim të arsyeshëm, objektiv dhe të pavarur në lidhje me përshtatshmërinë dhe efektivitetin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Tirana Bank;

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ekzekuton dhe është përgjegjës për detyrat e deleguara nga mbikëqyrësit e tij / saj;
- Komunikon drejtpërdrejt me eporët për problemet me të cilat përballet gjatë auditimeve;
- Zbaton metodologjinë për të siguruar arritjen e objektivave të Auditimit të Brendshëm të Grupit;
- Punon së bashku me departamentet / degët e brendshme për të analizuar çështjet dhe për të formuluar zgjidhje;
- Kryen hetime të veçanta ku dhe kur kërkohet;
- Kryen draft raportin e auditimit, siguron dokumentet e duhura të punës për të siguruar që ata mbështesin siç duhet raportin e auditimit dhe se janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme të auditimit;
- Ndjek zgjidhjen e të gjitha çështjeve të identifikuara gjatë auditimeve;
- Është përgjegjës për saktësinë dhe cilësinë e gjetjeve dhe konkluzioneve të auditimit, dhe për respektimin e afateve, dhe pajtueshmërinë me udhëzimet e dhëna

Kompetencat / aftësitë e kërkuara:

- Diplomë Bachelor dhe Master në Ekonomi ose disiplinë tjetër të ngjashme;
- Minimumi 3 vite eksperiencë në sektorin bankar, 2 vite përvojë në auditim janë të preferueshme;
- Njohuri shumë të mira mbi strukturat bankare, operacionet dhe pasqyrat financiare;
- Të njohë mirë fushën e auditimit dhe të ketë njohuri teknike të përditësuara;
- Aftësi të shkëlqyera komunikuese dhe shkruese raportesh në mënyrë konçize;
- Aftësi për të analizuar dhe zgjidhur problemet;
- Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale dhe vendim-marrëse;
- I/E aftë për të udhëtuar në një njoftim të shkurtër, duke përfshirë udhëtimin brenda natës;
- Njohuri të shkëlqyera shkruese dhe verbale të gjuhës angleze;
- Njohuri shumë të mira të paketës Microsoft (Word, Excel, Power Point);

Kandidatët e interesuar mund të dërgojnë një **CV** brenda datës **28 nëntor 2021** në [link](#)

Ju lutem kini parasysh që vetëm personat që plotësojnë kriteret e sipërpërmendura do të kontaktohen.

Të dhënat tuaja personale, të cilat dergohen nga ju vullnetarisht si përgjigje ndaj kësaj shpallje për vend të lirë pune, mbliidhen dhe përpunohen, manualisht dhe/ose elektronikisht, nga Banka Tirana sha, me qëllim vlerësimin e përshtatshmërisë tuaj për t'u punësuar në këtë vend pune, aksesohen vetëm nga persona të autorizuar të Bankës dhe do të ruhen deri në përfundim të procesit të përzgjedhjes së kandidatit fitues. Subjektet e të dhënave personale, mund të ushtrtojnë të drejtat e tyre sipas ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i ndryshuar, pranë Bankës Tirana sha, si dhe pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale